



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

Në bazë të nenit 11 të Statutit të Kolegjit BIZNESI në Prishtinë, Këshilli i Lartë Mësimor - Shkencor i Kolegjit BIZNESI më 14. 07. 2011 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR SIGURIMIN DHE VLERËSIMIN E CILËSISË

Këshilli i Lartë Mësimor-Shkencor, Këshillat e Departamenteve, Dekani dhe përgjegjësit e departamenteve janë përgjegjës për çështjet e lidhura me studimin, si dhe për ekzekutimin e masave përkatëse mbi cilësinë e ligjëratave dhe kushteve të punës e të studimit në Kolegjin “BIZNESI”.

Më qëllim të zhvillimit, monitorimit e revizionit në vazhdimësi të programeve dhe diplomave, Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor (KLMSH) ka krijuar Zyrën për Vlerësimin e Cilësisë.

Kjo rregullore specifikon rolin dhe përgjegjësitë e Zyrës së Vlerësimit të Cilësisë.

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim:

1. përcaktimin e mekanizmave dhe procedurave të sigurimit të vlerësimit në Kolegjin BIZNESI;
2. definojnë rolin dhe përgjegjësinë e njësive organizative dhe akademike për realizimin e aktiviteteve të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit;
3. definojnë mekanizmat dhe proceset, që përafrojnë Kolegjin BIZNESI me standardet e ENQA-s për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimit.

Neni 2

Qëllimet e sistemit të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit

1. Aktivitetet e vlerësimit realizohen për të identifikuar dhe promovuar praktikat e mira;
2. Aktivitetet e vlerësimit realizohen për të identifikuar elementet, që kërkojnë ndërhyrje për të përmirësuar gjendjen ekzistuese;
3. Aktivitetet e vlerësimit realizohen për të siguruar avancimin e vazhdueshëm të veprimitarisë së Kolegjit BIZNESI;
4. Aktivitetet e vlerësimit realizohen për të plotësuar kërkesat e sistemit të akreditimit që janë përcaktuar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.

Neni 3

Lloji i vlerësimeve në kuadër të sistemit të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit

1. Vlerësimet për qëllime të akreditimit institucional;
2. Vlerësimet për qëllime të akreditimit të programeve në nivel të njësive akademike.

Kolegji BIZNESI nëpërmjet Zyrës së Vlerësimit të Cilësisë bënë të mundur mbarëvajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së edukimit në përputhje me:

- Ligjin mbi Arsimin e Lartë;
- Aktin themelues dhe rregullore të tjera të Kolegjit BIZNESI;
- Standardet dhe linjat udhëheqëse mbi akreditimin të Agjencisë së Akreditimit të Kosovës;

Neni 4

Aktorët në sistemin e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit janë:

1. Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor;
2. Dekani;
3. Zyra për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë (menaxhimin e cilësisë).

Zyra e Vlerësimit dhe Sigurimit të Cilësisë është themeluar nga Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor, dhe kompetencat e saj janë të përcaktuara me këtë rregullore.

Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor është organi, që miraton Rregulloren e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit.

Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor miraton planifikimin për realizimin e aktiviteteve të sigurimit të cilësisë (menaxhimit të cilësisë).

Neni 5

Dekani

1. sigurohet që të ekzistojnë kushtet e duhura për realizimin e aktiviteteve të menaxhimit të cilësisë.
2. sigurohet që ekziston mbështetja financiare e nevojshme për të realizuar menaxhimin e cilësisë.
3. sigurohet që rezultatet e vlerësimeve të përkthehen në masa operative të duhura dhe shpërblime për praktikantët e mira.

Neni 6

Zyra e Vlerësimit dhe Sigurimit të Cilësisë (menaxhimit të cilësisë) ka këto kompetenca:

- Rrit profilin e sigurimit dhe vlerësimit të cilësisë, duke kultivuar një kulturë cilësie në Kolegjin BIZNESI;
- Siguron vijueshmërinë periodike dhe të përvitshme të programit të sigurimit dhe vlerësimit të cilësisë;
- Koordinon, grumbullimin e pikëpamjeve gjatë vijimit të kursit mësimor të pjesëmarrësve, në mënyrë të veçantë studentëve;
- Lehtëson rishqyrtimin e ekspertëve dhe informacionin mbi raportet e sigurimit dhe vlerësimit të cilësisë dhe hyrjen në planet e aksionit;
- Lehtëson reagimin dhe linjat e drejtimit për përpiluesit e rishqyrtimeve dhe raporteve;
- Lehtëson dhe inkurajon zhvillimin e stafit në mësimdhënie, në mësim dhe vlerësim;
- Është organ i autorizuar për aprovimin e versioneve të tashmë të lëndëve dhe programeve;
- Mban dhe bënë informacionet statistikore më qëllim të ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë;
- Merr përgjegjësinë për çdo lloj procesi shtesë të sigurimit dhe vlerësimit të cilësisë, si rishqyrtimi periodik që duhet të paraqitet nga Kolegji BIZNESI;
- Merr drejtimin në përgatitjen e dokumenteve për qëllime të jashtme si: akreditimi, bashkëpunimi i Kolegjit me organizata dhe institucioneve relevante;
- Pajis Dekanin me raportet mbi sigurimin dhe vlerësimin e cilësisë, përgjegjësit e programeve dhe Këshillin e Lartë Mësimor Shkencor, nëse kërkohet prej tyre;
- Asiston Dekanin dhe bartësit e programeve në zhvillimin dhe vënien në jetë të procedurave për verifikim dhe përmirësim të cilësisë;
- Përgatitë raport mbi verifikimin e cilësisë sipas kërkesës.

Neni 7

Ekipi për vlerësimin dhe zhvillimin (menaxhimin) e cilësisë është i përbërë nga:

- Shefi i Zyrës së Vlerësimit të Cilësisë,
- Një përfaqësues nga secili program,
- Shefi i administratës,
- Deri në dy anëtarë të kooptuar,
- Dy përfaqësues nga studentët me notë mesatare mbi 8 (tetë).

Për vlerësim dhe avancim të cilësisë, Zyra për Vlerësim të Cilësisë përkrahet edhe nga Komisionet e veçanta në kuadër të Kolegjit dhe të Zyrës për Vlerësim të Cilësisë.

Neni 8

Anëtarët e ekipit punues zgjidhen në mënyrë të posaçme nga Këshilli i Lartë Mësimor Shkencor i Kolegjit BIZNESI për një periudhë tre vjeçare më mundësi rizgjedhjeje.

Së paku një e treta e anëtarëve të ekipit qendror për sigurim të cilësisë dhe vlerësimit vazhdojnë në përbërjen e ekipit pas mandatit 3 vjeçar për të siguruar vazhdimësinë.

Ekipi qendror i sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit ka për detyrë:

- të hartojë udhëzuesin e aktiviteteve të vlerësimit të sigurimit të cilësisë;
- të hartojë instrumentet për vlerësim kualitativ dhe kuantitativ;
- të hartojë dhe shqyrtojë raportet e vlerësimit/vetëvlerësimit;
- të shqyrtojë raportet e vetëvlerësimit për akreditim institucional dhe të programeve;
- të shqyrtojë raportet e vetëvlerësimit për riakreditim institucional dhe të programeve në nivelin e adresimit të çështjeve të ngritura nga AKA;
- të miratojë anëtarët e grupeve punuese për realizimin e vlerësimeve sipas nevojës;
- të udhëheqë procesin e publikimit të raporteve vlerësuese.

Neni 9

Në secilin program, ekipet e programeve, nën autoritetin e përgjegjësve të përgjegjësve të programit përkatës, janë përgjegjës për monitorimin e cilësisë dhe përmirësimin e nivelit të programeve në përputhje me procedurat e aprovuara nga Kolegji BIZNESI.

Neni 10

Ekipet e programimit përgatisin planë aksion/revizion të përvitshëm, të nënshkruara nga Dekani, që i parashtrohen ekipit punues të sigurimit dhe vlerësimit të cilësisë të Kolegjit, duke bërë të mundur përdorimin e plotë të këtyre burimeve të informacionit në momentin e parashtrimit të paraqitjes Zyrës së Vlerësimit të Cilësisë.

Neni 11

Vlerësimi për akreditim institucional

1. Kolegji BIZNESI i realizon aktivitetet e vlerësimit në mënyrë të vazhdueshme në fushat:

- Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies;
- Vlerësimi i shërbimeve për studentët;
- Vlerësimi i aktivitetit shkencor dhe studimeve;
- Vlerësimi i shërbimeve administrative;
- Vlerësimi i bashkëpunimit ndërkombëtar;
- Vlerësimi i resurseve për mësimnxënie.

2. Të dhënat e vlerësimit të brendshëm shfrytëzohen për qëllime të akreditimit institucional të Kolegjit, sipas dispozitave të Agjencisë së Akreditimit të Kosovës dhe planifikimit të intervenimeve për përmirësim të veprimtarisë së Kolegjit BIZNESI;

3. Vlerësimi i veprimtarive të Kolegjit si në pikën 1 të këtij neni udhëhiqet nga Komisioni i sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit në Kolegj;
4. Procesin e vlerësimeve të veprimtarisë së Kolegjit si në pikën 1 të këtij neni e administron Dekani me ndihmën e koordinatoreve të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit dhe grupit punues, i cili themelohet sipas nevojës.

Neni 12

Vlerësimi për akreditim të programeve të studimit të Kolegjit

1. Dekani në koordinim me Shefin e Zyrës për sigurimin e cilësisë, udhëheqin procesin e akreditimit të programeve sipas kërkesave të Agjencisë së Akreditimit të Kosovës,
2. Vlerësimi, që bëhet për akreditim të programeve duhet të përfshijë informacione për:
 - Cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies;
 - Cilësinë e veprimtarisë shkencore;
 - Bashkëpunimin ndërkombëtar;
 - Perceptimet e të diplomuarve për cilësinë e studimeve;
 - Perceptimet e punëdhënësve për cilësinë e të diplomuarve;
 - Cilësinë e shërbimeve për studentët;
 - Cilësinë e kulturës organizative dhe menaxhimit.
3. Përveç dimensioneve të pikës 2 të këtij neni vlerësimi, që bëhet për akreditim të programeve merr për bazë edhe kriteret e tjera të specifikuar nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës

Neni 13

Ne të gjitha rastet kur Zyra për Vlerësimin e Cilësisë identifikon ose merr informata kthyese nga studentet për performancë të dobët të profesorit, ndërmerr të gjitha veprimet për eliminimin e shkaqeve dhe pasojave të mundshme.

Neni 14

Zyra për Vlerësim të Cilësisë lidhur me performancën e dobët të profesorit ndërmerr këto veprime konkrete: identifikon performancën e dobët të profesorit, nëpërmes informatave kthyese nga studentet (nëpërmes pyetësorëve vlerësues) ose drejtpërdrejt nga komisioni për vlerësim të cilësisë, bën analizë konkrete dhe profesionale të shkaqeve e arsyeve dhe rekomandon masat për avancim të cilësisë së performancës së profesorit konkret, duke i raportuar të dhënat përkatëse dhe masat e marra të përgjegjësi i programit përkatës, Dekani i Kolegjit BIZNESI, si dhe të strukturat përgjegjëse akademike të Kolegjit dhe ndërmerr veprime për ngritjen e cilësisë së performancës së profesorit (sipas nenit 15 të kësaj Rregulloreje) bashkë me njësitë e tjera përgjegjëse në Kolegj.

Në situatën e performancës së dobët dhe për shkak të mos interesimit të vazhdueshëm për angazhim të mësimdhënësit ose kur radhazi tri herë përcaktohet nga intervistat dhe anketat cilësia e dobët në mësimdhënie nga studentet, atëherë Zyra për Vlerësimin e Cilësisë i rekomandon Dekanit formimin e komisionit për vlerësim të performancës.

Komisioni mund të nxjerr dy lloje vendimesh vlerësuese: Vërejtjen e parë, parapërrjashtim nga procesi mësimdhënës dhe përfundimisht largimin e tij.

Komisioni vlerësues përbehet nga 3 mësimdhënës, një përgjegjës nga programi përkatës dhe dy mësimdhënës me përvojë nga lëndët e caktuara për vlerësim.

Neni 15

Duke u kujdesur për mbajtjen dhe rritjen e cilësisë në Kolegj, për stafin akademik dhe studentët, ekipi punues i sigurimit dhe vlerësimit të cilësisë mund të propozojë aktivitete të tjera që konsistojnë në mbajtjen apo rritjen e cilësisë. Kjo mund të arrihet me: seminare, trajnime, mbledhje

pune, debate, publikime të brendshme, konsultime, vorkshope dhe forma te tjera shtesë për rritjen e performancës dhe cilësisë në Kolegjin BIZNESI.

Neni 16

Shefi i Zyrës së Vlerësimit të Cilësisë në ambientet e zyrës së tij mban një komunikim të hapur e të ndershëm me organet dhe njësitë e Kolegjit, siç është vendosur me aktet e Kolegjit BIZNESI, që të bëhet i mundur sigurimi i zhvillimit akademik.

Neni 17

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm është në dispozicion, duke ofruar ndihmën teknike për ekipin punues të Zyrës për Vlerësimin e Cilësisë.

Neni 18

Kjo rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas miratimit nga ana e Këshillit të Lartë Mësimor-Shkencor të Kolegjit BIZNESI.



Prof. Dr. Shyqeri Kabashi

Dekan